



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:161342

Datë: 20.09.2021

Numri i dokumentit: 02189195

P.nr.514/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurve F.. S.... dhe D.... I. që të dy nga Gj.. për shkak të veprës penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr..../2021 të datës 19.07.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 14.09.2021 dhe pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurve, me datë 14.09.2021 mori dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

Të pandehurit:

- I. F...S.... nga babai D... dhe nëna B....., e lindur K....., i lindur me datë ..... në Gj... ku dhe jeton rruga: "F.... A...." nr..., i martuar, baba i ..fëmijëve, ka të kryer 5 vite të shkollës fillore, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, rom, shtetas i Republikës së Kosovës dhe
- II. D.. I. nga A... dhe nëna M.. e lindur K..., i lindur me datë ..... në Gj....., ku dhe jeton në lagjen "P.....", p.nr, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punësuar, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

JANË FAJTOR

Sepse me datë 20.06.2021 rreth orës 16:45 minuta në Gjilan, në rrugën "A.. P.....", me marrëveshje paraprake dhe me qëllim të përfitimit material për vete kanë marrë pronën e huaj nga oborri i xhamisë-dy palë atlete të markës "N...", në pronësi të dëmtareve B. K... dhe B.. B..., ashtu që kanë hyrë në oborrin e xhamisë dhe kanë marrë atletet e lartcekura derisa të dëmtuarit në atë kohë po faleshin në xhami dhe pastaj duke ecur rrugës "A. P..." me atletet e vjedhura janë ndaluar nga policia.

-Me çka kanë kryer veprën penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,42,43,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 248 dhe 365 të KPP-ës të pandehurit e lartcekur:

### I GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje nga 4 (katër) muajve dhe dënim me gjobë në shumë nga 300 € (treqind euro) për secilin prej tyre veç e veç të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse të pandehurit nuk dëshirojnë, nuk mundën ose nuk janë në gjendje ta paguajnë dënimet me gjobë atëherë dënimet me gjobë do t'iu zëvendësohen në dënime me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do t'iu caktohet nga një ditë burgim.

Të dëmtuarit B..K.. dhe B.. B... për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohen të pandehurit që secili prej tyre veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej nga 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### ARSYETIM

#### 1.Rrjedha e çështjes.

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 22.07.2021 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr..../2021 kundër të pandehurve F... S... dhe D... I... që të dy nga Gj.. për shkak të veprës penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Me datë 14.09.2021 pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit dhe të pandehurit F.S....dhe D.. I..., me ç' rast në këtë seancë paraprakisht meqenëse i pandehuri F.. është i nacionalitetit rom i njejtë është pyetur nga gjyqtari i vetëm gjykues nëse e kupton gjuhën në të cilën është duke u zhvilluar seanca dhe nëse ka nevojë për përkthyes mirëpo i njejtë ka deklaruar se e kupton gjuhën në të cilën është duke u zhvilluar seanca dhe se nuk ka nevojë për përkthyes dhe më pas seanca ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit

derisa më pas të pandehurit secili prej tyre veç e veç kanë deklaruar se e kuptojnë në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet duke shtuar se pranojnë fajësinë për kryerjen e saj, pranimi i fajësisë ky i cili nuk ishte kundërshtuar nga ana e palëve prezente andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurve dhe seanca ka vazhduar me deklaramet e palëve lidhur me dënimin.

## 2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata në seancën e shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezente palët e lartcekura pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurve për veprën penale e cila u vihet në barrë ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1-1.4 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e tyre nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e tyre, se të pandehurit nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2021-CA-.... i datës 20.06.2021, deklaratat e të pandehurve të dhëna në polici, raporti i oficerit, foto dokumentacioni si dhe shkresat e tjera të lëndës gjithashtu gjykata me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurve gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: të pandehurit F.. S.. dhe D.. I.. kanë kryer veprën vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## 4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurve duhet t'iu shqiptohen dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesve si dhe përgjegjësinë penale të tyre ashtu që me rastin e matjes së dënimeve pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesve e cila nga provat materiale në shkresat e lëndës del të jetë e lartë meqenëse të pandehurit me rastin e kryerjes së veprës penale kanë qenë të përgjegjshëm për veprimet e tyre dhe veprën penale e kanë kryer me dashje dhe atë direkte po ashtu me

rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, sjelljen e mëparshme të kryesve meqenëse për të pandehurit nuk është hera e parë që bien ndesh me ligjin e sidomos për vepra penale të tilla si dhe pranimin e fajit nga ana e tyre.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata është bazuar edhe në rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethanë lehtësuese për të pandehurit gjykata mori pranimin e fajësisë nga ana e tyre për kryerjen e veprës penale e cila u vihet në barrë, pendimin e tyre për kryerjen e saj të cilat gjykata i mori si pendime të thella dhe reale, keqardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurve, kërkim faljen e tyre si dhe premtimin e tyre që në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla dhe as vepra të tjera ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurit gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e tyre sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del se të njëjtit këtë vepër penale e ka kryer me dashje dhe atë direkte duke e ditur se me veprimet e tyre do të shkaktohet pasoja e ndaluar dhe përkundër kësaj ata e kanë dëshiruar përkatësisht kanë ndërmarrë veprime për shkaktimin e saj ashtu siç përshkruhet në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjithashtu si rrethanë rënduese për të pandehurit gjykata mori edhe këmbëngulësinë e shfaqur nga ana e të tyre për kryerjen e veprës penale sepse siç shihet nga përshkrimi faktik po ashtu edhe nga provat e çështjes del se të njëjti kanë hyrë në oborrin e xhamisë dhe derisa të dëmtuarit ishin duke kryer ritet fetare të pandehurit i kanë marrë atletet e tyre dhe në fund si rrethanë rënduese për të pandehurit gjykata mori edhe faktin se vepra penale përfshin disa viktima përkatësisht është drejtuar kundër pasurisë së të dëmtuarëve B. K.. dhe B.. B... andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i KPRK-ës gjykata të pandehurve u shqiptoj dënimet brenda kufijve ligjore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurve mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 5. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur që të dëmtuarit B...K... dhe B.. B.. ti udhëzoj në kontest të rregullt juridiko civil për realizimin e saj.

## 6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurit veç e veç ti detyrojë ta paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) si shumën prej nga 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.514/2021 me datë 14.09.2021

Zyrtarja Ligjore,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermahaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.